



Pranuar / Preritur Received / Delivered	04 - 11 2022	viti god year	2
Organi / Bësta Organ / Bësta Org / Bst	Nr Prot Bt Prot Prot No	Shtojta Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SLUŽBESHOK	6731/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.823/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.823/2022 të datës 23.09.2022, të parashtruar nga ankuesit dhe të cilët me autorizim i përfaqëson avokate në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.823/2022, e datës 23.09.2022, e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesit që të gjithë të punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me datë 23.09.2022 përmes përfaqësues me autorizim avokates kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 5637/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Financave, me pretendimin ankimor që t'i njihet e drejta e kompensimit të pagave jubilarë, shujtave ditore dhe shtesave tjera.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa nga Njësia e Personelit të Agjencisë së Punësimit më datë 04.10.2022 janë pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5637/2022 të datës 23.09.2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të protokollit 1913-4/2022

të datës 06.09.2022; Autorizimin e datës 21.04.2021 të ankuesit S.Sadiku lidhur me përfaqësimin e avokates Akt Emërimin me shenjën APRK 100 të datës 28.12.2017 të ankuesit Akt emërimin me numër të protokollit 12/12 të datës 16.07.2012 të ankueses Autorizimin e ankueses lidhur me përfaqësimin e avokates T.Beka; Akt emërimin me shenjën APRK-103 të datës 14.01.2016 të Autorizimin e datës 21.01.2021 të lidhur me përfaqësimin e avokates Autorizimin e datës 21.04.2021 të ankuesit lidhur me përfaqësimin e avokates Akt emërimin e ankuesit F.Bunjaku me shenjën APRK-1010 të datës 28.12.2017; Akt emërimin e ankuesit të datës 01.11.2012; Autorizimin e datës 21.04.2021 të ankuesit lidhur me përfaqësimin e avokates Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5708/2022 të datës 27.09.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5836/2022 të datës 04.10.2022; Listën e pagave të muajit 01.09.2017 përmes të cilës dëshmohet se ankuesit i është bërë kompensimi i shpërblimit jubilarë në vlerën prej 93.50 euro dhe ju është bërë kompensimi i shpërblimit jubilarë në vlerën prej 93.50 euro; Listën e pagave të datës 01.11.2020 përmes të cilës dëshmohet se ankuesi i është bërë kompensimi i jubilarës II në vlerë prej 97.24 euro; Listën e pagave të datës 01.09.2022 përmes të cilës dëshmohet se ankueses i është bërë kompensimi i shpërblimit jubilarë në vlerë prej 93.80 euro; Listën e pagave të datës 01.04.2022 përmes të cilës dëshmohet se ankueses i është bërë kompensimi i shpërblimit jubilarë II në vlerë prej 97.24; Listën e pagave të datës 01.09.2017 përmes të cilës dëshmohet se ankuesi i është bërë kompensimi i shpërblimit jubilarë në vlerë prej 93.50 euro.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesve *është e pa pranueshme, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur së ankuesit janë të punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, dhe atë ankuesi sipas Akt emërimit me shenjën APRK 102 të datës 28.12.2017 është i punësuar në pozitën e punës " Zyrtar për Shërbime të Punësimit" Zyra e Punësimit në Kamenicë, ankuesi sipas Akt emërimit me shenjën APRK 101 të datës 28.12.2017 është i punësuar në pozitën e punës " Zyrtar për Shërbime të Punësimit" Zyra e Punësimit në Kamenicë, ankuesi sipas Akt emërimit me shenjën APRK 103 të datës 28.12.2017 është i punësuar në pozitën e punës " Zyrtar për Shërbime të Punësimit" Zyra e Punësimit në Kamenicë, ankuesja sipas Akt emërimit me shenjën APRK 99 të datës 28.12.2017 është e punësuar në pozitën e punës " Këshilltarë" Zyra e Punësimit në Viti, dhe ankuesi sipas Akt emërimit me shenjën APRK 100 të datës 28.12.2017 është i punësuar në pozitën e punës " Udhëheqës i Zyrës së Punësimit" Zyra e Punësimit në Kamenicë.

Ankuesit përmes përfaqësues me autorizim kanë parashtruar kërkesë të organi i punësimit për kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore dhe shtesave tjera, ndërsa me datë 23.09.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet e njëjta ankimore për kompensim material dhe me kërkesën që Këshilli të obligojë punëdhënësin që t'i njoh të drejtën në kompensim material të pagave jubilarë, shujtave dhe shtesave tjera, për periudhën kohore nga datat 06.09.2017 deri me datë 06.09.2022, bazuar në dispozitat ligjore që parasheh Ligji për Nëpunësit Civil, Ligji për Paga dhe Kontrata e Përgjithshme Kolektive.



Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës i'u referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 98 më të cilin është përcaktuar se: 1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj...”, si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...” e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në provat e çështjes, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesve e datës 23.09.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, pasi që ankuesit ende pa pranuar përgjigje nga organi i punësimit lidhur me kërkesën e ankuesve të datës 06.09.2022, rrejdhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, mbi ketë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesve e parashtruar në Këshill me datë 23.09.2022 është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.”

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.823/2022

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses me autorizim të ankuesve avokates
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.